



Prishtinë, 16.02.2022
Kodi i ZRRE-së: V_1498_2022

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke marrë parasysh:

- Dispozitat e Nenit 9 paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, 1.4 dhe 1.7, Nenit 19, Nenit 23 paragrafi 1.2, Nenit 26, paragrafit 1.1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Rregullën për Taksa (Rregulla ZRRE/Nr.01/2020),

në seancën e mbajtur me datë 16 shkurt 2022 nxori këtë:

VENDIM

- I. NDRYSHOHET taksa vjetore e licencimit nga € 0.20/MWh në € 0.15/MWh e përcaktuar me pikën B1 të Shtojcës 1 të Rregullit për Taksat.**
- II. Të gjitha dispozitat tjera të Rregullit për Taksa (Rregulla ZRRE/Nr.01/2020) mbesin të pandryshuara.**

Arsyetim

- o Taksat e inkasuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji, janë të hyra të dedikuara të Rregullatorit.
 - o Me Rregullin për Taskat përcaktohet niveli i taksave të cilat mbliidhen nga të Licencuarit, me të cilat financohen aktivitetet e Rregullatorit, duke përfshi shpenzimet e administratës, shpenzimet operative, pagat dhe shpenzimet tjera të përcaktuara me Ligjin për Rregullatorin e Energjisë.
 - o Niveli i taksave përcaktohet në përputhje me buxhetin vjetor të Rregullatorit, andaj Rregullatori ka vlerësuar se me përcaktimin e taksës si në pikën I të dispozitivit të këtij Vendimi do mjaftojë për mbulimin e shpenzimeve për kryerjen efektive të obligimeve të saja.
- III. Vendimi nxirret në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.**
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të Rregullatorit.**



Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimt të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të Rregullatorit, cilado që ndodh e fundit.

Vendimi i dërgohet:

- Arkivit të Zyrës së Rregullatorit për Energji

Bordi i Rregullatorit:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Selman Hoxhi, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Lutfije Dervishi, anëtare

Gani Bogaj, anëtar



SHTOJCA 1: TABELË PËR KATEGORITË E TAKSAVE PËR LICENCIM

KATEGORITË E TAKSAVE PËR LICENCIM	Taksat në EURO
A. TAKSË FILESTARE E LICENCIMIT PËR:	
A1. PRODHIM TË ENERGISË (Burime fosile, burime të ripërtërishme, bashkëprodhim i energjisë elektrike dhe energjisë termike)	1,000. ⁰⁰ €
A2. OPERATOR I SISTEMIT TË TRANSMISIONIT	1,000. ⁰⁰ €
A3. OPERATOR I TREGUT	1,000. ⁰⁰ €
A4. OPERATOR I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES	1,000. ⁰⁰ €
A5. FURNIZIM ME SHUMICË (TREGTIM)	1,000. ⁰⁰ €
A6. FURNIZIM ME ENERGI ME PAKICË	2,000. ⁰⁰ €
A7. RISHIKIM-MODIFIKIM/NDRYSHIM APO VAZHDIM, DHE TRANSFER NË LIDHJE ME A.1-A6	500. ⁰⁰ €
B. TAKSË VJETORE E LICENCIMIT PËR:	
B1. PRODHIMI I ENERGISË & IMPORTI	€ 0.15/MWh
B2. PRODHIM I ENERGISË NGA BURIMET E RIPËRTËRISHME TË ENERGISË DHE BASHKËPRODHIMI	€ 0.10/MWh
C. TAKSË PËR LËSHIMIN E CERTIFIKATATËS SË ORIGINËS	€ 0.00/MWh
D. TAKSË PËR ZGJIDHJEN E KONTESTEVE	€ 0.00/MWh

SHTOJCA 2: TABELË PËR KATEGORITË E TAKSAVE PËR AUTORIZIME

KATEGORITË E TAKSAVE PËR AUTORIZIM	Taksat në EURO
A. TAKSË PËR SHQYRTIM TË APLIKACIONEVE PËR AUTORIZIM:	
A1. AUTORIZIM PËR NDËRTIM TË KAPACITETIT TË RI	1,000. ⁰⁰ €
A2. RISHIKIM/NDRYSHIM DHE MODIFIKIM I AUTORIZIMIT	500. ⁰⁰ €